



4147/19

12.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:245034

Datë: 20.06.2023

Numri i dokumentit: 04412565

**Ka. nr. 226/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e Kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Naim(Rrustem)Elshani, pronar i Subjekti ekonomik NTP “Flamuri”, Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e Suharekës, për kundërvajtje nga neni 6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri NTP “Flamuri”, përmes pronarit Naim(Rrustem)Elshani, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.1019/22, të datës 12.05.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 3, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 16.06.2023 mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga i pandehuri Subjekti ekonomik - Person fizik NTP “Flamuri”, Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e suharekës, me pronar Naim(Rrustem)Elshani, sipas detyrës zyrtare

**NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.1019/22, i datës 12.05.2023, sa i përket cilësimit juridik të kundërvajtës ashtu që ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik - Person fizik NTP “Flamuri”, Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e Suharekës, me pronar Naim(Rrustem)Elshani, vepra kundërvajtëse cilësohet sipas nenit 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, ndërsa i muret si i vërtetuar dënimi me gjobë në shumë prej **2.100(dymijëqind)€**, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, **por varsisht nga gjendja ekonomike mund ta paguaj në 5 këste, duke u bazuar në nenin 30 par. 1 të LK-së**, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

**Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.**

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

## Arsyetim

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut, në Prishtinë, me numër të Ref. 19/22 të datës 18.11.2022, e me numër të Protokollit 7047-19, me aktgjykim K.nr.1019/22, të datës 12.05.2023, të pandehurin Subjekti ekonomik - Person fizik NTP “Flamuri”, Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e suharekës, me pronar Naim(Rrustem)Elshani, e ka shpall përgjegjës sepse:

-me datë 29.09.2022, gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të MTI-së, të Subjekti ekonomik - Person fizik NTP “Flamuri”, Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e Suharekës, është konstatuar se ushtron veprimtarin ekonomike pa Licencë për shitje me pakicë të GLN-së, me ç veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, dhe konform nenit 35 të LK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej **2.100(dymijënjëqind)€**, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, por varsisht nga gjendja ekonomike mund ta paguaj në **5 këste**, duke u bazuar në nenin 30 par. 1 të LK-së, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Me të njëjtin aktgjykim është obliguar i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor – shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej **5(pesë)€**, në aftë të njëjtë sikurse edhe gjobën.

Kundër aktgjykimit ka ushtruar ankesë i pandehuri NTP “Flamuri”, Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e Suharekës, me pronar Naim(Rrustem)Elshani, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kundërvajtëse, aplikimit të gabuar të ligjit material me të cilin është paraparë kundërvajtja, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi sanksionin kundërvajtës, në të cilën veç tjerash thekson se: subjekti në fjalë me rastin e inspektimit nuk ka qenë duke shitur GLN-së, pompa ka funksionuar normal por nuk ka bërë shitje të GLN-së, edhe sot e kësaj dite nuk funksionon verimtaria e shitjes me pakicë të GLN-së. Po ashtu në ndërkohë kanë qenë inspektorët e MINT-së, të cilët kanë konstatuar mbylljen e pikës së shitjes së GLN-së. Duke u bazuar në faktin se vendimi është nxjerr në konstatim të gabuar të gjendjes faktike është bërë edhe zbatimi i gabuar i ligjit material. Po ashtu sipas Kërkesë është inicuar procedura ndaj NTP “Flamuri”, Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e Suharekës, me pronar Naim(Rrustem)Elshani, dhe vlen të ceket se ndaj Naim Elshanit asnjëherë nuk është inicuar procedurë kundërvajtëse. Gjykata sipas nenit 10 të Lk-së, duhet përshtatshmërisht ti ybaton dispozitat e Kodit Penal. Andaj aktgjykimi ka tejkalluar akuzën, pasi që ka shpall përgjegjës Naim Elshanin për të cilin nuk ka Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Konsideron se në rastin konkret gjykata ka dështuar ta vërteton gjendjen faktike për faktin se e ka dënuar me gjobë pronarin e subjektit edhe pse nuk ka qenë duke shitur me pakicë GLN-së. Gjendja kundërligjore nuk ka ekzistuar në momentin e inspektimit, edhe kjo është menjanuar pasi që Inspektorët e kanë mbyllur pikën e shitjes së GLN-së, andaj gjykata në kuptim të nenit 36 të LK-së, është dashtë ta pezulloj procedurën për arsye të menjanimit të gjendjes kundërligjore. Gjykata e shkallës së parë jo vetëm që nuk e ka Pezulluar procedurën për faktin e menjanimit të kundërligjshmërisë por edhe nuk e ka trajtuar si rrethanë lehtësuese, duke tejkalluar kërkesën për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, duke e dënuar me gjobë pronarin e këtij subjekti.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i ankimuar të Anulohet vendimin e shkallë së parë ose ta Hedh poshtë Kërkesën pasi që ekziston baza për përjashtimin e përgjegjesisë kundërvajtëse.

Kolegji i kësaj Gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur si dhe në bazë të deklaratës së Pronarit të NTP "Flamuri", Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e Suharekës, të dhënë pranë Gjykatës së shkallës së parë, në Procesverbal të datës 28.02.2023, i cili ka deklaruar se subjekti në fjalë me rastin e inspektimit nuk ka qenë duke shitur GLN-së, subjekti - pompa ka funksionuar normal, por nuk ka bërë shitje të GLN-së, edhe sot e kësaj dite nuk funksionon verimtaria e shitjes me pakicë të GLN-së. Po ashtu në ndërkohë më datë 11.01.2023, kanë qenë inspektorët e MINT-së, të cilët kanë konstatuar edhe mbylljen e pikës së shitjes së GLN-së, në bazë të Procesverbalit të Inspektimit Nr. 00245 të datës 31.01.2022, Kërkesës së të pandehurit të datës 09.11.2022, për mbylljen e aparatit për shitjen e GLN-së, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprë kundërvajtëse nga neni neni 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshme, të cilën gjykata e shkallës së parë bazuar në nenin 5 të LK-së, e ka ri - kualifikuar pasi që Ligji i cili është tani në fuqi është më i favorshëm për të pandehurin, por pa e precizuar saktësisht, andaj edhe është bërë ndryshimi sa i përket cilsimit të saktë të veprës kundërvajtëse. Te përkufizimet në Ligjin Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshme, në nenin 3 par. 1 pika 1.6. citim "**karburantet e naftës** - karburantet e përfituara nga nafta, siç janë dizelli, benzina, karburanti në fushën e aviacionit, **gazi i lëngëzuar i naftës** (GLN) gazoili, vaji i rëndë për nxehje, vajguri, koksi i naftës dhe produktet e tjera për djegie, që do të thotë se GLN është Karburant i naftës, andaj për këtë kundërvajtje mban përgjegjësi dhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, Kolegji e NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur, sa i përket cilsimit juridik të kundërvajtjes ashtu që vepra kundërvajtëse për të cilën i pandehuri është shpall përgjegjës - cilësohet si veprë kundërvajtëse nga neni 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme dhe të pandehurit Subjektit Ekonomik - Person fizik NTP "Flamuri", Biznes Individual, me seli në Duhël – Komuna e Suharekës, me pronar Naim(Rrustem)Elshani, i është mare si i vërtetuar dënimi me gjobë në shumë prej **2.100(dymijëqind)€**, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë se të pandehurit, peshën, rrezikshmërinë, pasojat e veprës se kryer, duke konsideruar se me gjobën e shqiptuar tani do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ashtu që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të njëjta apo të ngjashme.

Në vështrim të nenit 143 par. 1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**Ka. nr. 226/2023, me datë 16.06.2023**

UAKTËROJË E KOPJES E VERTETON  
UDHËHEQËSI I SHKRIMORES SË GJYKATËS  
TAČNOST KOPIJE POTVRĐUJE  
RUKOVODIOČ SUDSKE PISARNICE



**KRYETARIA KOLEGJIT,**

**Azra Cakolli**

*A. Cakolli*